

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**" GROPA INTERNACIONAL" SHPK**

Sot me daten 03.12.2022 ,themeluesi:

Elmaz Gropa i biri i Velo,i datelindjes 02.05.1950, lindur ne Grizë,Patos,Fier,Shqiperi dhe banues ne Fier,Shqiperi me Adrese Rruga e Gropallareve,Patos,Fier, identifikuar me Nr ID F00502051E.

Ne perputhje me Ligjin nr.9901 Date 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 date 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Ka vendosur te themeloje Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar "GROPA INTERNACIONAL" Shpk.

**Neni 1.**

**EMERTIMI I SHOQERISE**

Shoqeria do te quhet " GROPA INTERNACIONAL" SHPK

**Neni 2**

**SELIA E SHOQERISE**

Selia e shoqerise eshte ne adresen:

**Prefektura/Qarku:Fier,Rrethi:Fier,Bashkia:Patos,Qyteti:Patos,Rruga e Gropallareve ,  
Ndertesa Nr.10/11,Kati 3,ZK 2890.**Shoqeria mund te hape filiale te tjera ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise si dhe ne te gjitha shtetet jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

**Neni 3**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :

Import-Export i vajit te ullirit, frutave dhe perimeve, grumbullim perpunim tregtim i ullirit.



#### Neni 4

### KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

Kapitali themeltar i shoqerise do jete 100.000 (Njeqind mije)Leke.Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme qe nenkuptohet i perbere nga 1(nje)kuote me vlere te pergjithshme prej 100.000 leke.Kjo kuote i perket ortakut te vetem si me poshte:

1. Elmaz Gropa ID Nr.F00502051E zoterues i 1(kuote) me vlere te pergjithshme 100.000 leke perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te ortakeve.

#### Neni 5

### KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohe te pacaktuar.

#### Neni 6

### ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Administrator i shoqerise do te jete Z.Anxhelo Gropa ID Nr.I70415019B, i cili emerohet per nje periudhe 5-vjecare, me te drejte rizgjedhje. Nje Administrator tjeter mund te emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Ortakeve. Adrnistratori ka te gjithe kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te trete ne emer te shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep ortakeve.

#### Neni 7

### VENDIME TE ASAMBLESE SE PERGJITESHME


Asambleja e pergjitheshme eshte organi me i larte vendimmarres.

Vendimet e asamblese se pergjitheshme merren bazuar ne perqindjen e kapitalit e zoteruar prej secilit ortak, konform pikes 1 neni 86 i ligjit 9901 dt.14.04.2008 "Per shoqerite Tregtare",

Te gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjitheshrne regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Duhet regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;



d) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria proven se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

#### **Neni 8**

#### **NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi do te shperndahet midis ortakeve respektivisht sipas kuotave te kapitalit themeltar te investuar te shprehura ne nenin 4 te ketij akti. Fitimi i destinuar per tu shperndare perbehet nga fitimi i vitit financiar .te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per rezerven ligjore dhe te tjera rezerva statutore , si dhe duke i shtuar apo zbritur respektivisht humbjet e mbartura nga vitet e meparshme.

#### **Neni 9**

#### **LIKUIDIMI**

Shoqeria eshte ne likuidim e siper qe ne momentin e prishjes se saj, operacion i cili do te kryhet sipas kerkesave te parashikuara ne legjislacionin tregetar shqipetar.

#### **Neni 10**

#### **MOSMARREVESHJET**

Mos marreveshjet zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert,Themeluesi do ti drejtohet Gjykates se Rrethit per zgjidhje.

#### **SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“GROPA INTERNACIONAL” Shpk**

**Ortaku**

**ELMAZ GROPA**

